

VENDIM
Nr. 65, datë 1.12.2021

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR ZOTËRIMIN E KONTROLLIT TË
TËRTHORTË TË 100 PËR QIND TË KAPITALIT AKSIONAR TË BANKËS
ALPHA ALBANIA SHA NGA AKSIONARI I TËRTHORTË ALPHA BANK SA,
GREQI**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “e”, të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të shkronjës “gj”, të pikës 1, të nenit 24, si dhe të nenit 25, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin për zotërimin e kontrollit të tërthortë të 100 për qind të kapitalit aksionar të Bankës Alpha Albania sh.a. nga aksionari i tërthortë Alpha Bank s.a., Greqi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare

KRYETAR
Gent Sejko